


Besimi i çdo Muslimani



Shejkh
Xhemil Zejno

Allahu e mëshiroftë





Titulli: Besimi i çdo Muslimani

Titulli i librit në origjinal: عقيدة كل مسلم

Autor: Shejkh Xhemil Zejno

Përktheu: Firdeus Ilir Çorja

Redaktoi: Albiona Olluri

Botues: Gjurmët e Dijes

www.gjurmetedijes.com



Për çdo vërejtje, mendim apo kontribut, ju lutem na
kontaktoni në adresën : gjurmetedijes@gmail.com

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

❁ 1. Përse na ka krijuar Allahu i Lartësuar?

Allahu i Lartësuar na ka krijuar që ta adhurojmë Atë dhe mos t'i shoqërojmë Atij asgjë në adhurim. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë Mua.”¹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Obligimi i robit ndaj Allahut është që ta adhurojë Atë dhe të mos i shoqërojë Atij askënd në adhurim."*²

❁ 2. Si duhet ta adhurojmë Allahun?

Allahun duhet ta adhurojmë ashtu siç na ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, me sinqeritet dhe pasim të sunnetit.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ﴾

¹ Edh Dharijat, 56.

² Mutefekun alejhi.

“...ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë...”³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush punon një vepër e cila nuk është sipas traditës sonë, ajo është e refuzuar (nuk pranohet)."*⁴

❁ 3. A duhet ta adhurojmë Allahun me frikë dhe shpresë njëkohësisht?

Po, Atë e adhurojmë me frikë dhe shpresë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَادْعُوهُ خَوْفًا وَطَمَعًا﴾

“...dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin e Tij) dhe duke shpresuar (mëshirën e Tij)”⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"I lutem Allahut për Xhenetin dhe tek Ai kërkoj mbrojtje nga zjarri."*⁶

❁ 4. Ç'është Ihsani në adhurim?

Ta ndiesh mbikëqyrjen e Allahut të Vetëm, i Cili na sheh dhe di çdo gjë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا﴾


³ El-Bejjineh, 5.

⁴ Muslimi.

⁵ El-A'raf, 56.

⁶ Sahih, Ebu Daud.

"Vërtetë që Allahu është mbikëqyrës mbi ju." ⁷



"Është Ai i Cili të sheh kur ti ngrihesh në këmbë (falesh)." ⁸

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Ihsani (mirësia) është ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh Atë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty." ⁹

❁ 5. Përse Allahu i ka dërguar të Dërguarit e Tij?

Allahu i ka dërguar profetët për t'i ftuar njerëzit në adhurimin ndaj Tij dhe që të mohohet adhurimi ndaj çdo gjëje tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Allahu i Lartësuar thotë:



“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhurojeni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!”¹⁰

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Profetët janë vëllezër dhe feja e tyre është një (të gjithë profetët kanë thirrur popujt e tyre në Teuhid (Njësimin e Allahut))." ¹¹

⁷ En-Nisa', 1.

⁸ Esh-Shuara, 218.

⁹ Muslimi.

¹⁰ En-Nahl, 36.

¹¹ Mutefikun alejhi.



❁ 6. Çfarë nënkuptojmë me Teuhidin Uluhije (Njësimi i Allahut në adhurim)?

Me *Teuhidin Uluhije* nënkuptohet njësimi i Allahut në adhurim, si: në lutje, zotim, gjykim dhe në të tjera adhurime. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَاعْلَمُوا أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ﴾

"Dije se nuk ka të zot tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut." ¹²

Pra, askush tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Le të jetë dëshmia La ilahe il-la Allah (Njësimi i Allahut) gjëja e parë në të cilën do t'i ftosh ata."* ¹³

❁ 7. Ç'do të thotë: "La ilahe il-la Allah"?

Dëshmia *La ilahe il-la All-llah* ka kuptimin se "nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut".

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ الْبَطْلُ ﴾

"Kjo sepse Allahu është i Vërteti dhe se çdo gjë që adhurojnë përveç Atij është e kotë." ¹⁴

¹² Muhamed, 19.

¹³ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁴ Lukman, 30.


I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

*"Kush thotë " La ilahe il-lAll-llah" dhe mohon atë që adhurohet përveç Tij, ai e ka të shenjt gjakun dhe pasurinë e tij."*¹⁵

❁ 8. Çfarë nënkuptojmë me Teuhid Esma ue Sifat, (Njësimi i Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij)?

Me teuhidin *Teuhid Esma ue Sifat* nënkuptojmë pohimin e Emrave dhe Cilësive të Allahut ashtu siç e ka cilësuar Vetën e Tij, apo siç e ka cilësuar Atë i Dërguari i Tij, pa shëmbëllim pa krahasim, pa komentim të gabuar, pa mangësim.

Thotë Allahu i Lartësuar:



"Asnjë send nuk është si Ai; Ai është Dëgjuesi dhe Vështruesi i çdo gjëje."¹⁶

Thotë i Dërguari i Allahut ﷺ: *"Zoti i Lartëmadhëruar zbret në qiellin e kësaj bote çdo natë."*, (zbritje e veçantë që i takon vetëm të Madhërishmit)¹⁷

❁ 9. Çfarë dobie ka Teuhidi për muslimanin?

Teuhidi (njësimi i Allahut në adhurim) ka dobinë e udhëzimit në këtë botë dhe sigurisë në botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

¹⁵ Muslimi.

¹⁶ Esh Shura, 11.

¹⁷ Mutefekun alejhi.

﴿الَّذِينَ ءَامَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَٰئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ

مُهْتَدُونَ ﴿٨٢﴾

"Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë të udhëzuarit." ¹⁸

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Obligimi i Allahut ndaj robërve të Vet është që të mos i dënojë ata që nuk i kanë shoqëruar ndokënd në adhurim." ¹⁹

❁ 10. Ku është Allahu i Lartësuar?

Allahu i Lartësuar është mbi qiej, mbi Arsh, ashtu siç i takon Atij, Madhërisë së Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَىٰ ﴿٥﴾﴾

"I Gjithëmëshirshmi u ngrit mbi Arsh

(vërtet ashtu siç i shkon madhësisë së Tij)." ²⁰

(d.m.th: u ngrit e u lartësua, siç thuhet në Sahihun e Buhariut)

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Allahu ka shkruar në një libër: "Mëshira Ime tejkalon Hidhërimin Tim", e ai libër ndodhet i shkruar tek Ai, mbi Arsh." ²¹

¹⁸ El-En'am, 82.


¹⁹ Mutefekun alejhi.

²⁰ Ta-Ha, 5.

²¹ Bukhariu.

❁ 11. A është Allahu me ne me Qenien e Tij apo me Dijen e Tij?

Allahu është me ne me Dijen e Tij, na sheh dhe na dëgjon. Allahu i Lartësuar thotë:



"Tha: Mos u frikësoni sepse Unë jam me ju, iu dëgjoj dhe iu shoh." ²²


I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Vërtet, ju i luteni Atij që dëgjon dhe është afër jush (me dijen e Tij, Ai iu shikon dhe iu dëgjon.)"*

^{23 24}

❁ 12. Cili është mëkati më i madh?

Mëkati më i madh është shirku (shokvënia Allahut).

Allahu i Lartësuar thotë:



"Kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: "O biri im! mos i përshkruaj Allahut shok, sepse shirku është padrejtësia më e madhe." ²⁵

²² Ta-Ha, 46.

²³ Muslimi.


²⁴ Duhet ta dimë se Cilësitë e Allahut janë të pabarabarta dhe janë të pakrahasueshme me ato të krijesave. Ato besohen pa i shtrembëruar, pa i krahasuar apo barazuar me cilësitë e krijesave. Allahu është i Pastër dhe i Denjë për çdo lavd.

²⁵ Lukman, 13.

E pyetën të Dërguarin e Allahut ﷺ : "Cili është mëkati më i madh tek Allahu?" Ai tha: "T'i bësh Allahut shok/rival, ndërsa Ai të ka krijuar ty." ²⁶

❁ 13. Ç'është shirku i madh?

Shirk i madh është çdo adhurim që bëhet për tjetër kënd përveç Allahut, si: duaaja (lutja), kurban, etj. Allahu i Lartësuar thotë:




"Thuaj: Unë i lutem vetëm Zotin tim dhe Atij nuk i bëj asnjë shok!" ²⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Mëkati më i madh është shirku/shokvënia ndaj Allahut." ²⁸

❁ 14. Çfarë dëmi rrjedh nga shirku i madh?

Shirku i madh është shkak për qëndrim të përhershëm në zjarr të xhehenemit. Allahu i Lartësuar thotë:



"Sigurisht, atij që adhuron tjetër kënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri." ²⁹

²⁶ Muslimi.

²⁷ El-Xhinn, 20.

²⁸ Buhariu.


²⁹ El-Maide. 72.



I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Kush vdes duke i shoqëruar Allahut diçka në adhurim, ai do të hyjë në zjarr." ³⁰

❁ 15. A i sjell dobi puna/vepra atij që e shoqëron atë me shirk të madh?

Nuk bën dobi asnjë punë e shoqëruar me shirkun e madh. Allahu i Lartësuar thotë:




"E sikur t'i përshkruajnë shok Zotit kishte për t'iu shkuar huq ajo që kanë vepruar." ³¹

Thotë Allahu i Lartësuar në një Hadith Kudsij: "Kush vepron një punë duke më bërë shirk në të, do ta lë atë dhe shirkun e tij." ³²

❁ 16. A ekziston shirku në mesin e muslimanëve?

Po, fatkeqësisht ekziston. Allahu i Lartësuar thotë:



"Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, vetëm se duke i shoqëruar (zota të tjerë)." ³³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Nuk do të ndodhë dita e

³⁰ Muslimi.

³¹ El-En'am, 88.


³² Muslimi.

³³ Jusuf, 106.

kiametit, derisa disa nga fiset e popullit tim të pasojnë idhujtarët dhe derisa të adhurojnë idhuj." ³⁴

❁ 17. Cili është gjykimi për lutjen që i drejtohet dikujt tjetër përveç Allahut, siç janë evliatë?

Të luturit atyre (evliave) është shirk, i cili të futë në Zjarr. Allahu i Lartësuar thotë:




“Prandaj, mos lut tjetër zot, përveç Allahut, që të mos bëhesh nga ata që do të dënohen!” ³⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush vdes duke lutur dikë tjetër përveç Allahut, do të hyjë në Zjarr."* ³⁶

❁ 18. Lutja është adhurim ndaj Allahut ?

Po, duaaja (lutja) është adhurim ndaj Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:



"Dhe Zoti juaj thotë: “Më lutni Mua, Unë do t'ju përgjigjem!” ³⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Lutja është vetë adhurimi."* ³⁸

³⁴ Sahih, Tirmidhiu.

³⁵ Esh-Shuara, 213.

³⁶ Buhariu.

³⁷ Gafir, 60.

³⁸ Sahih, Tirmidhi

❁ 19. A e dëgjojnë të vdekurit lutjen (duanë)?

Të vdekurit nuk e dëgjojnë lutjen (duanë).

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّكَ لَا تَسْمَعُ الْمَوْتَى﴾

“Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t’i bësh të vdekurit të dëgjojnë...”³⁹

﴿وَمَا أَنْتَ بِمُسْمِعٍ مَّن فِي الْقُبُورِ﴾

“...nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.”⁴⁰

❁ 20. A lejohet kërkimi i ndihmës prej të vdekurve, apo prej atyre që nuk janë të pranishëm?

Nuk kërkohet ndihmë prej tyre, ndihmë kërkohet vetëm prej Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ﴾

"Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai iu përgjigj juve." ⁴¹

Sa herë që Profetin ﷺ e brengoste, apo e pikëllonte ndonjë çështje, ai thoshte: "O Ti që je i Përjetshëm dhe Mbajtës i gjithçkaje! Me Mëshirën Tënde kërkoj që të më ndihmosh!" ⁴²

³⁹ En Neml, 80.


⁴⁰ Fatir, 22.

⁴¹ El-Enfal, 9.

⁴² Transmeton Tirmidhiu.

❁ 21. A lejohet kërkimi i ndihmës prej dikujt tjetër përveç Allahut?

Nuk lejohet kërkimi i ndihmës prej dikujt, përveç prej Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:




"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!" ⁴³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Nëse kërkon ndihmë kërkoje vetëm tek Allahu." ⁴⁴

❁ 22. A lejohet të kërkojmë ndihmë prej të gjallëve që janë të pranishëm ?

Po, kjo lejohet në ato gjëra që janë brenda mundësive të njeriut, por jo në ato gjëra që i takojnë vetëm Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar thotë:



"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!" ⁴⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Allahu është në ndihmë të robit të Tij, derisa robi është në ndihmë të vëllait të tij." ⁴⁶

⁴³ El-Fatiha, 5.

⁴⁴ Transmeton Tirmidhiu.

⁴⁵ El-Maide, 2.

⁴⁶ Muslimi.



❁ 23.A lejohet zotimi në dikë tjetër përveç Allahut?

Nuk lejohet zotimi në dikë tjetër pos për Allahun e Madhëruar. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّي ۖ ﴾

“Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të të shërbejë vetëm Ty; andaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë.”⁴⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Kush zotohet/betohet për të kryer një punë që është bindje ndaj Allahut, le ta bëjë atë e kush zotohet/betohet për të bërë një punë e cila thyen urdhrin e Allahut, mos ta bëjë atë." ⁴⁸

❁ 24. A lejohet prerja e kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut?

Therja e kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut të Madhëruar nuk lejohet, sepse kjo është shirk i madh.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَخَرِ ﴾

⁴⁷ El-Imran, 35.


⁴⁸ Bukhariu.

"Andaj ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!" ⁴⁹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Allahu e mallkoftë atë që ther kurban për dikë tjetër përveç Allahut!" ⁵⁰*

❁ 25. A lejohet rrotullimi (tauafi) rreth varreve?

Nuk lejohet tauafi rreth ndonjë gjëje tjetër përveç rreth Qabesë. Allahu i Lartësuar thotë:



"...dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë (Qabesë)." ⁵¹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush sillet (bën tauaf) rreth Qabesë shtatë herë dhe pastaj fal dy rekate, konsiderohet sikur ka liruar një robëreshë." ⁵²*

❁ 26. A lejohet të falesh diku nëse përpara ka varr?

Nuk lejohet namazi në drejtim të varrit.

Allahu i Lartësuar thotë:



⁴⁹ El-Keuther, 2.

⁵⁰ Muslimi.

⁵¹ El Haxh, 29.

⁵² Ibn Maxheh.

“...ktheje fytyrën tënde nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja)!” ⁵³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Mos u ulni mbi varre dhe mos u falni drejt tyre!" ⁵⁴

✿ 27. Si gjykohet të punuarit me magji?

Të punuarit me magji është mosbesim dhe mohim i Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ﴾

"...Por shejtanët mohuan (u bënë mosbesimtarë) sepse u mësonin njerëzve magjinë." ⁵⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Largojuni shtatë mëkateve shkatërruese: shirkut, magjisë..." ⁵⁶

✿ 28. A lejohet të shkojmë tek magjistari apo fallxhori?

Nuk lejohet të shkojmë assesi tek ta. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أَنْبِئْكُمْ عَلَىٰ مَنْ تَنْزَلُ الشَّيَاطِينُ﴾ ﴿٢٢١﴾ تَنْزَلُ عَلَىٰ كُلِّ آفَاكٍ أَثِيمٍ ﴿٢٢٢﴾

"A doni t'ju tregoj se kujt i vijnë djajtë? Ata i vijnë çdo gënjeshtari gjynahqar." ⁵⁷

⁵³ El-Bekare, 144.

⁵⁴ Muslimi.

⁵⁵ El-Bekare, 102.

⁵⁶ Muslimi.

⁵⁷ Shuara, 221-222.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: “Kush shkon tek një fallxhor dhe e pyet për diçka, nuk i pranohet namazi dyzet net.”⁵⁸

❁ 29. A mund t'i besojmë fallxhorit apo magjistarit?

Nuk i besojmë ata për asgjë se çfarë thonë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ لَا يَعْلَمُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ وَمَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ

يُبْعَثُونَ﴾

"Thuaj: Nuk e di të fshehtën askush që ndodhet në qiej apo në tokë përveç Allahut."⁵⁹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Kush shkon tek një fallxhor dhe i beson fjalëve që thotë, ai ka mohuar Kuranin dhe traditën profetike."⁶⁰

❁ 30. A e di të fshehtën (gajbin) dikush përveç Allahut?

Nuk e di të fshehtën askush tjetër përveç Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ﴾

⁵⁸ Muslimi.

⁵⁹ En-Neml, 65.

⁶⁰ Sahih, Bukhari.

"Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di askush përveç Tij." ⁶¹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Nuk e di të fshehtën askush tjetër përveç Allahut."* ⁶²

❁ 31. Me çfarë ligji obligohen të gjykojnë muslimanët?

Muslimanët e kanë obligim të gjykojnë sipas Kur'anit dhe Sunetit. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَنِ احْكُم بِمَا أُنزَلَ اللَّهُ﴾

"...gjykoji sipas asaj që ka shpallur Allahu..." ⁶³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Allahu është Gjykuesi dhe tek Ai është kthimi."* ⁶⁴

❁ 32. Cili është gjykimi për ligjet e vendosura, të cilat kundërshtojnë Islamin?

Zbatimi i këtyre ligjeve është kufër/mohim, nëse personi i konsideron të lejuara. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ﴾

⁶¹ El-En'am, 59.

⁶² Hasen, Tirmidhi.

⁶³ El-Maide, 49.

⁶⁴ Ebu Daudi, hasen

"E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mosbesimtarë." ⁶⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Nëse prijësit e tyre nuk gjykojnë me librin e Allahut dhe zgjedhin diçka tjetër, Allahu fut në mes tyre armiqësi." ⁶⁶

❁ 33. A lejohet betimi në dikë tjetër përveç Allahut?

Jo, nuk lejohet betimi në dikë tjetër përveç Allahut.
Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ﴾

"Thuaj: Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjallen." ⁶⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Kush betohet në diçka tjetër përveç Allahut, ka bërë shirk." ⁶⁸

❁ 34. A lejohet vendosja e nuskave dhe hajmalive?

Nuk lejohet varja, lidhja e nuskave apo e hajmalive, sepse kjo është shirk. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَإِنْ يَمَسُّكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ﴾

⁶⁵ El-Maide, 44.

⁶⁶ Ibn Maxheh

⁶⁷ Et Tabagun, 7.

⁶⁸ Sahih, Ahmed.

"Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s'ka kush që ta largojë atë përpos Tij." ⁶⁹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush var apo lidh hajmali, i ka bërë shirk/shok Allahut."* ^{70 71}

✿ 35. Me çfarë ndërmjetësojmë tek Allahu i Lartësuar?

Tek Allahu ndërmjetësojmë me Emrat dhe Cilësitë e Tij, gjithashtu dhe me punët tona të mira. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا﴾

"Dhe të Allahut janë gjithë Emrat më të bukur, kështu që luteni Atë me ta..." ⁷²

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Të lutem Ty me çdo Emër Tëndin, me të cilin Ti ke emërtuar Vetën Tënde!"* ⁷³

✿ 36. A ka nevojë lutja për ndërmjetësimin e ndonjë krijese, me qëllim që ajo të pranohet tek Allahu?

Kur lutemi, s'ka nevojë për ndërmjetësimin e ndonjë krijese. Allahu i Lartësuar thotë:

⁶⁹ El-En'am, 17.

⁷⁰ Sahih, Ahmed.

⁷¹ Hajmali është çdo gjë që bartet, me mendimin për ta parandaluar apo larguar syrin e keq.

⁷² El-A'raf, 180.

⁷³ Sahih, Ahmed.

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ

إِذَا دَعَانِ

"Dhe kur robërit e Mi të pyesin ty (o Muhamed) për Mua, atëherë (thuaje): Vërtet Unë jam pranë, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet. " ⁷⁴

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Vërtet, ju i luteni Atij që dëgjon dhe është afër jush. [d.m.th. me dijen e Tij Ai iu shikon dhe iu dëgjon]." ⁷⁵

✿ 37. Cili është misioni i Profetit Muhammed ﷺ?

Misioni i tij është përcjella, transmetimi, kumtimi i fesë. Allahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الرُّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ

“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! ” ⁷⁶

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: “O Zoti im, a e kumtova mesazhin? O Zoti im, dëshmo!” E tha këtë si përgjigje për fjalën e shokëve të tij, kur thanë: "Dëshmojmë që ti e kumtove shpalljen." ⁷⁷

⁷⁴ El-Bekare, 186.

⁷⁵ Muslimi.

⁷⁶ El-Maide, 67.

⁷⁷ Muslimi.

❁ 38. Prej kujt kërkojmë që të na mundësohet ndërmjetësimi i Profetit Muhammed ﷺ?

Ndërmjetësimin e Muhammedit ﷺ e kërkojmë vetëm prej Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ لِلَّهِ الشَّفَعَةُ جَمِيعًا﴾

"Thuaj: I tërë ndërmjetësimi i takon Allahut." ⁷⁸

Transmetohet kjo lutje: "O Zoti im! Bëje atë (Profetin Muhammed ﷺ) ndërmjetësues për mua!"⁷⁹

❁ 39. Si realizohet dashuria ndaj Allahut dhe Profetit ﷺ?

Dashuria vërtetohet me bindje dhe zbatimin e urdhrave. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ﴾

"Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t'ju dojë." ⁸⁰

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Nuk beson askush prej jush, derisa të jem më i dashur për të sesa prindi i tij, fëmija e tij dhe të gjithë njerëzit." ⁸¹

⁷⁸ Ez-Zumer, 44.

⁷⁹ Hasen, Tirmidhi.

⁸⁰ Al-Imran, 31.

⁸¹ Buhariu.

❁ 40. A lejohet ta teprojmë në lavdërimin ndaj Profetit ﷺ?

Nuk lejohet ta teprojmë në lavdërimin ndaj Profetit ﷺ. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُمُ إِلَهٌ وَاحِدٌ﴾

"Thuaj (O Muhammed): "Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se i Adhuruari juaj i vërtetë është vetëm Një (Allahu)."⁸²

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Vërtet unë jam njeri sikurse edhe ju."*⁸³

❁ 41. Cila është krijesa e parë?

Krijesa e parë prej njerëzve është Ademi (Paqja e Allahut qoftë mbi të), ndërsa prej gjërave është lapsi. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي خَلَقْتُ بَشَرًا مِّن طِينٍ﴾

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj një njeri nga balta."⁸⁴

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Gjëja e parë që ka krijuar Allahu është lapsi."*⁸⁵

⁸² El-Kehf, 110.

⁸³ Ahmedî, saktësoi shejh Albani.

⁸⁴ Sad, 71.

❁ 42. Prej nga cila gjë është krijuar Muhammedi ﷺ?

Allahu e ka krijuar Muhammedin ﷺ ashtu siç e ka krijuar çdo krijesë tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ﴾

"Ai (Allahu) është që ju krijoi juve (të parin tuaj) prej dheu, pastaj prej një pike uji ..." ⁸⁶

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Vërtetë, secili prej jush zhvillohet brenda mitrës së nënës së tij për dyzet ditë në gjendje të lëngët."* ⁸⁷

❁ 43. Çfarë gjykimi ka lufta në rrugën e Allahut?

Lufta e shenjtë është obligim për muslimanët me pasuri, trup dhe gjuhë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿انْفِرُوا خِفَافًا وَثِقَالًا وَجَاهِدُوا بِأَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ﴾

"Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj." ⁸⁸

⁸⁵ Ebu Daud, Tirmidhiu, hasen sahih.

⁸⁶ Gafir, 67.

⁸⁷ Buhariu dhe Muslimi.

⁸⁸ Et-Teube, 41.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Luftojini idhujtarët me pasuritë, trupat dhe gjuhët tuaja." ⁸⁹

❁ 44. Ç'është miqësia ndaj besimtarëve?

Është dashuria dhe përkrahja ndaj besimtarëve, ndaj atyre që e njësojnë Allahun. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ﴾

"Besimtarët dhe besimtares janë evlia (të dashur, ndihmues, përkrahës) për njëri-tjetrin." ⁹⁰

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë e vetme, pjesët e të cilës mbajnë fort njëra-tjetrën." ⁹¹

❁ 45. A lejohet miqësia me mosbesimtarët dhe përkrahja e tyre?

Nuk lejohet miqësia me mosbesimtarët dhe as përkrahja e tyre. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ﴾

"E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre." ⁹²

⁸⁹ Sahih, Ebu Daud.

⁹⁰ Et-Teube, 71.

⁹¹ Muslimi.

⁹² El-Maide, 51.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Vërtetë, bijtë e filan fisit nuk janë miq të mi."^{93 94}

❁ 46. Kush është evlia (mik dhe i dashur i Allahut)?

Evlia është besimtari i devotshëm. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ﴾

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (euliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të devotshëm."⁹⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Miku im është Allahu dhe besimtarët e mirë."⁹⁶

❁ 47. Përse Allahu e shpalli Kur'anin?

Allahu e ka zbritur Kur'anin për të punuar sipas tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿اتَّبِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ﴾

"Pasoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos zini miq (përkrahës) pos Tij."⁹⁷

⁹³ Buhariu dhe Muslimi.

⁹⁴ Shkaku se ata nuk ishin besimtarë.

⁹⁵ Junus, 62-63.

⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi.

⁹⁷ El-A'raf, 3.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Lexojeni Kur'anin dhe punoni me të, e mos e keqpërdorni për interesa materiale(pasuri)." ⁹⁸

❁ 48. A mjaftohemi vetëm me Kur'anin pa hadithin [sunnetin]?

Nuk mund të mjaftohemi me Kur'anin pa hadithin.
Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ﴾

"Ty ta zbritëm përkujtimin (hadithin) që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre (Kur'anin)." ⁹⁹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Vërtetë që mua më është dhënë Kur'ani dhe një i ngjashëm si ai (sunneti)." ¹⁰⁰

❁ 49. A duhet t'i japim përparësi ndonjë fjale para Fjalëve të Allahut dhe të dërguarit të Tij?

Nuk lejohet t'i japim përparësi ndonjë fjale para Fjalës së Allahut dhe fjalës së të dërguarit të Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْدِمُوا بَيْنَ يَدَيِ اللَّهِ وَرَسُولِهِ﴾

⁹⁸ Transmeton Ahmedi.

⁹⁹ En-Nahl, 44.

¹⁰⁰ Sahih, Ebu Daud.

"O besimtarë, mos i jepni përparësi asgjëje para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të dërguarit të Tij."¹⁰¹

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Nuk lejohet bindja ndaj krijesës, duke bërë mëkat ndaj Krijuesit, por bindja është në punë të mira."*¹⁰²

❁ 50. Si të veprojmë nëse kundërshtohemi me njëri-tjetrin?

Duhet të kthehemi te Kur'ani dhe Suneti i saktë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَإِنْ نَزَعْنَاهُ مِنْ شَيْءٍ فَزِدْهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ ﴾

"Nëse kundërshtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te Allahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari."¹⁰³

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kam lënë në mesin tuaj dy gjëra, nëse kapeni pas tyre, nuk do të humbni kurrë: Librin e Allahut dhe Sunetin e të dërguarit të Tij."*¹⁰⁴

¹⁰¹ El-Huxhurat, 1.

¹⁰² Buhariu dhe Muslimi.

¹⁰³ En-Nisa'. 59.

¹⁰⁴ Sahihli gajrihi, imam Maliku.

51. Ç'është bidati (risitë/shpikjet) në fe?

Bidat është çdo vepër për të cilën nuk ka argument fetar.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ﴾

"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi Allahu?" ¹⁰⁵

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush shpik ne fenë tonë diçka që nuk është prej saj, ajo i nuk i pranohet."*¹⁰⁶

✿ 52. A ka në fe bidat të mirë?

Në fe nuk ka bidat të mirë, çdo bidat çon në humbje.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ

الْإِسْلَامَ دِينًا﴾

"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj."¹⁰⁷

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kini kujdes nga shpikjet në fe, sepse çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat të shpie në humbje."*¹⁰⁸

¹⁰⁵ Esh-Shura, 21]

¹⁰⁶ Buhariu dhe Muslimi.


¹⁰⁷ El-Maide, 3.

¹⁰⁸ Sahih, Ebu Daud.

❁ 53. A ka në Islam Sunnet të mirë?

Natyrisht që po. Në këtë mënyrë, një person fillon/vepron një punë të mirë, me të cilën bëhet shembull tek të tjerët.

Allahu i Lartësuar thotë:



"...e neve na bën shembull për të devotshmit..."¹⁰⁹


D.m.th. shembull në punë të mira.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kush vepron në Islam një sunnet të mirë, do të ketë shpërblim për të, gjithashtu edhe shpërblimin e atyre që e pasojnë pas tij."*

❁ 54. A i mjafton njeriut vetëm përmirësimi i vetes së tij?

Duhet patjetër që ta përmirësojë veten dhe familjen e tij.

Allahu i Lartësuar thotë:



"O ju që keni besuar! Ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një Zjarri, lëndë djegëse e të cilët janë njerëzit dhe gurët."¹¹⁰

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Allahu i Lartësuar do ta pyesë*

¹⁰⁹ El-Furkan, 74.

¹¹⁰ Tahrir, 6.

çdo përgjegjës për atë që kishte në përgjegjësi, a e ruajti atë apo e humbi. ”¹¹¹

❁ 55. Kur do të triumfojnë muslimanët?

Muslimanët do të triumfojnë kur të punojnë sipas Librit të Zotit të tyre (Kuranit) dhe udhëzimeve të Profetit ﷺ (Sunetin). Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن نَّصُرُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ﴾

"O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun, Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja." ¹¹²

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "Një grup nga ummeti (populli im) do jetë vazhdimisht triumfues."¹¹³

❁ 56. Cilët janë njerëzit më të mirë pas profetëve?

Ata janë shokët e Profetit ﷺ . Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَالسَّابِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ

اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَّضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ﴾

"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve

¹¹¹ Hasen, Nisai

¹¹² Muhammed, 7.

¹¹³ Sahih, Ibn Maxheh.

ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij."¹¹⁴

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Njerëzit më të mirë janë bashkëkohësit e mi, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre."*¹¹⁵

✿ 57. Cilët janë shokët me të mirë të Profetit ﷺ (sahabët)?

Sahabët më të mirë janë: Ebu Bekri, më pas Umeri, pastaj Uthmani, e më pas Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Allahu i Lartësuar thotë:

إِلَّا نَصْرُوهُ فَقَدْ نَصَرَهُ اللَّهُ إِذْ أَخْرَجَهُ الَّذِينَ
كَفَرُوا ثَانِيًا أَتَيْنِ إِذْ هُمَا فِي الْغَارِ إِذْ يَقُولُ
لِصَاحِبِهِ لَا تَحْزَنْ إِنَّا اللَّهُ مَعَنَا

"Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin), Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): "Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!"¹¹⁶

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kapuni fort pas sunnetit tim dhe sunnetit të prijëseve të udhëzuar dhe të drejtë."*¹¹⁷

¹¹⁴ Teube, 100.

¹¹⁵ Buhariu dhe Muslimi.


¹¹⁶ Teube, 40.

¹¹⁷ Buhariu dhe Muslimi.

❖ 58. Ç‘grykim ka për atë që thotë se Kur’ani është ndryshuar?

Kush e thotë këtë, konsiderohet i dalë nga feja.

Allahu i Lartësuar thotë:




"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij." ¹¹⁸

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Kam lënë në mesin tuaj dy gjëra, nëse kapeni pas tyre, nuk do të humbni kurrë: Librin e Allahut dhe Sunetin e të dërguarit të Tij."* ¹¹⁹

❖ 59. Cilët janë ata që *"kundër vetes tërhoqën hidhërimin"* dhe ata që *"e humbën veten"* ?

Ata të cilët tërhoqën hidhërimin e Allahut janë çifutët, ndërsa ata që e humbën veten e tyre janë të krishterët.

Allahu i Lartësuar thotë:



"...jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!" ¹²⁰

¹¹⁸ El-Hixhr, 9.

¹¹⁹ Sahih li gajrihi, imam Maliku.

¹²⁰ El-Fatiha, 7.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: *"Ata të cilët kanë tërhequr hidhërimin e Allahut, janë çifutët. Ata që e kanë humbur rrugën, janë të krishterët."*¹²¹

Uel-hamdulilahi Rabbil-alemin.
Çdo falenderim i përket Allahut, Zotit të botëve.



¹²¹ Tirmidhiu.



Përmbajtja:

1. Përse na ka krijuar Allahu i Lartësuar ?	3
2. Si duhet ta adhurojmë Allahun?	3
3. A duhet ta adhurojmë Allahun me frikë dhe shpresë njëkohësisht?.....	4
4. Ç'është Ihsani në adhurim?.....	4
5. Përse Allahu i ka dërguar të Dërguarit e Tij?	5
6.Çfarë nënkuptojmë me Teuhidin Uluhiye (Njësimi i Allahut në adhurim)?	6
7. Ç'do të thotë: "La ilahe il-la Allah"?.....	6
8. Çfarë nënkuptojmë me Teuhid Esma ue Sifat, (Njësimi i Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij)?.....	7
9.Çfarë dobie ka Teuhidi për muslimanin?	7
10. Ku është Allahu i Lartësuar?.....	8
11. A është Allahu me ne me Qenien e Tij apo me dijen e Tij?..	9
12. Cili është mëkati më i madh?.....	9
13. Ç'është shirku i madh?	10
14. Çfarë dëmi rrjedh nga shirku i madh?	10
15. A i sjell dobi puna/vepra atij që e shoqëron atë me shirk të madh?.....	11
16. A veprohet shirku në mesin e muslimanëve?	11
17. Cili është gjykimi për lutjen ndaj të tjerëve përveç Allahut, siç janë evliatë?	12
18. A është lutja prej adhurimit ndaj Allahut të Lartësuar?	12
19. A e dëgjojnë të vdekurit lutjen (duanë)?	13
20. A lejohet kërkimi i ndihmës prej të vdekurve, apo prej atyre që nuk janë të pranishëm?.....	13



21. A lejohet kërkimi i ndihmës prej dikujt tjetër përveç Allahut?	14
22. A lejohet të kërkojmë ndihmë prej të gjallëve që janë të pranishëm?	14
23. A lejohet zotimi në diçka tjetër përveç Allahut?	15
24. A lejohet prerja e kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut?	15
25. A lejohet rrotullimi (tauafi) rreth varreve?	16
26. A lejohet të falesh diku nëse përpara ka varr?	16
27. Si gjykohet të punuarit me magji?	17
28. A lejohet të shkojmë tek magjistari apo fallxhori?	17
29. A mund t'i besojmë fallxhorit apo magjistarit?	18
30. A e di të fshehtë (gajbin) dikush përveç Allahut?	18
31. Me çfarë ligji obligohen të gjykojnë muslimanët?	19
32. Cili është gjykimi për ligjet e vendosura, të cilat kundërshtojnë Islamin?	19
33. A lejohet betimi në dikë tjetër përveç në Allahun?	20
34. A lejohet vendosja e nuskave dhe hajmalive?	20
35. Me çfarë ndërmjetësojmë tek Allahu i Lartësuar?	21
36. A ka nevojë lutja për ndërmjetësimin e ndonjë krijese, me qëllim që ajo të pranohet tek Allahu?	21
37. Cili është misioni i Profetit Muhammed?	22
38. Prej kujt kërkojmë që të na mundësohet ndërmjetësimi i Profetit Muhammed?	23
39. Si realizohet dashuria ndaj Allahut dhe Profetit ?	23
40. A lejohet ta teprojmë në lavdërimin ndaj Profetit ?	24
41. Cila është krijesa e parë?	24
42. Prej nga cila gjë është krijuar Muhammedi ?	25
43. Çfarë gjykimi ka lufta në rrugën e Allahut?	25
44. Ç'është miqësia ndaj besimtarëve?	26

45. A lejohet miqësia me mosbesimtarët dhe përkrahja e tyre?	26
46. Kush është evlia (mik dhe i dashur i Allahut)?	27
47. Përse Allahu e shpalli Kur'anin?	27
48. A mjaftohemi vetëm me Kur'anin pa hadithin [sunnetin]?	28
49. A duhet t'i japim përparësi ndonjë fjale para Fjalëve të Allahut dhe të dërguarit të Tij?	28
50. Si të veprojmë nëse kundërshtohemi me njëri-tjetrin?	29
51. Ç'është bidati (risitë/shpikjet) në fe?	30
52. A ka në fe bidat të mirë?	30
53. A ka në Islam Sunnet të mirë?	31
54. A i mjafton njeriut vetëm përmirësimi i vetes së tij?	31
55. Kur do të triumfojnë muslimanët?	32
56. Cilët janë njerëzit më të mirë pas profetëve?	32
57. Cilët janë sahabët më të mirë?	33
58. Ç'gjykim ka për atë që thotë se Kur'ani është ndryshuar?	34
59. Cilët janë ata që “ <i>kundër vetes tërhoqën hidhërimin</i> ” dhe ata që “ <i>e humbën veten</i> ”?	34

